


ANALIZE MBI ZHVILLIMET E FUNDIT NË DIALOGUN KOSOVË-SERBI: Një perspektivë nga Brukseli

—
Prill 2019





GROUP FOR LEGAL
AND POLITICAL
STUDIES

Grupi për Studime Juridike dhe Politike

Grupi për Studime Juridike dhe Politike është institut i pavarur, jo-partiak dhe jo-fitimprurës i politikave publike, me seli në Prishtinë, Kosovë.

Misioni ynë është që të realizojmë studime kredibile të politikave në fushën e politikës, së drejtës, dhe ekonomisë, si dhe të avancojmë zgjedhje politikash që adresojnë dështimet dhe/apo trajtuar problemet në fushat e caktuara të politikave.

legalpoliticalstudies.org

Analizë Politikash 06/2019

ANALIZE MBI ZHVILLIMET E FUNDIT NË DIALOGUN KOSOVË-SERBI: Një perspektivë nga Brukseli

Autore: Bárbara Matias*

Prill 2019

© Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Prill 2019.

Opinionet e shprehura në këtë dokument pasqyrojnë ato të Grupit për Studime Juridike dhe Politike, stafit bashkëpunëtorëve ose përfaqësuesve të tyre. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet ose të transmetohet në çfarëdo forme apo nga çfarëdo mjeti pa leje. Kontaktoni zyrën administrative të Grupit për Studime Juridike dhe Politike për kërkesat e tilla. Informacioni mbi kontaktet mund të gjendet në faqen e internetit të Grupit. Nëse dëshironi ta përdorni këtë dokument më tutje, ju lutem kontaktoni GSJP për leje.

Grupi për Studime Juridike dhe Politike
Rr. "Rexhep Luci", 16/1
Prishtinë 10 000, Kosovë
Webfaqja: www.legalpoliticalstudies.org
E-mail: office@legalpoliticalstudies.org
Tel/fax.: +381 38 234 456

*Ish -Hulumtuuese Ndërkombëtare, Grupi për Studime Juridike dhe Politike

ANALIZE MBI ZHVILLIMET E FUNDIT NË DIALOGUN KOSOVË-SERBI: NJË PERSPEKTIVË NGA BRUKSELI

Hyrje

Publikimi i dokumentit mbi Politikën e re të Zgjerimit të BE-së në shkurt të vitit 2018, nga Komisioni Evropian dha indikacione se po krijoheshin kushtet për të plotësuar dëshirën e kahmotshme të Ballkanit Perëndimorë për antarësim në BE. Si Kosova ashtu edhe Serbia janë të përfshira në politikën e re të zgjerimit, edhe pse me perspektiva të ndryshme. Serbia është vendosur si kandidat i parë dhe i është caktuar viti 2025 si afat kohorë konkret për antarësim, në anën tjetër, Kosova është përcaktuar si kandidate potenciale, megjithatë jo në formë të prerë, për shkak të problemit të mosnjohjeve nga disa shtete anëtare. Parakushti i përbashkët i Serbisë dhe Kosovës është arritja e marrëveshjes reciproke në Dialogun për normalizimin e marrëdhënieve mes tyre, Dialogu u përmbyll në vitin 2018 dhe filloi në vitin 2019 me arritje të përziera, me disa pengesa si dhe tensionet e fundit.

Ky raport vështron detalisht kahjen që po merr dialogu, duke filluar nga zhvillimet në të dy akterët shtetëror, në Kosovë dhe Serbi, për të vazhduar me një analizë se si partnerët Evropian janë duke i'u çasur zhvillimeve të fundit, dhe si po e parakushtëzojnë vazhdimin e bisedimeve për normalizimin e marrëdhënieve.

Gjatë muajve të fundit, kanë ngjarë ndryshime të rëndësishme, edhe pse jo pozitive në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve Serbi – Kosovë. Marrëveshja e ashtuquajtur e Brukselit, u arrit më 19 prill 2013, në të cilën të dy shtetet u pajtuan të përipiqen bashkarisht për të normalizuar marrëdhëniet me ndërmjetimin e BE-së. Në fund të vitit 2018, pati ngecje në bisedimet politike për të arritur fazën e fundit të marrëveshjes, për shkak të mospajtimeve rreth tri pikave përçarëse: 'korrigjimi i kufijeve', vendosja e taksës dhe formimi i ushtrisë së Kosovës. Akterët ndërkombëtarë me pjesëmarrjen dhe reagimin e tyre, janë përpoqur të zbusin tensionet dhe ngërçin në dialog.

Ideja kontraverse e 'korrigjimit të kufijëve'

Me vazhdimin e dialogut, rritet edhe mosdurimi i qeverive për të arritur përfundimisht normalizimin e marrëdhënieve, me një marrëveshje ligjore dhe të kënaqshme për të dyja palët. Këto pritje veçanërisht për Kosovën janë shumë të rëndësishme, perspektiva integruese e së është ende në fazë të hershme dhe varet kryesisht nga progresi me Serbinë, e cila në anën tjetër, ka filluar bisedimet për praninë. Megjithatë, dëshira për të arritur marrëveshjen rritet, gatishmëria për kompromis me një palë jobashkëpunuese bie.

Ideja e korrigjimit të kufijëve fillimisht u propozua nga Presidenti I Kosovës. Hashim Thaçi, kjo ide parashihte shkëmbim terriroresh mes Kosovës dhe Serbisë, përkatësisht, një pjesë jugore e Serbisë e banuar kryesisht me shqiptarë të shkëmbehej me pjesën veriore të Kosovës, ku serbët janë shumicë. Presidenti Thaçi u deklarua se "Kosova është e vendosur për të arritur një marrëveshje të detyrueshme ligjore, dhe koha është tash!"¹. Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq shqyrtoi mundësitë e kësaj ideje, në një aspekt më të gjerë për të arritur një marrëveshje përfundimtare dhe t'a përshpejtojë antarësimin.

Një ide mjaft kontraverse, e cila nuk u përkrah nga popullata në përgjithësi si dhe u konsiderua e rrezikshme duke pasur parasysh se ndarja e kufijëve në vija etnike mund të ngjallë tensione në rajonin e Ballkanit. Studiuesi austriak, Florian Bieber në lidhje me temën e Ballkanit

¹. Politico, "Presidentët e Kosovës dhe Serbisë i propozojnë ndryshimet kufitare për marrëveshjen historike", 25 gusht, <https://www.politico.eu/article/aleksandar-vucic-hashim-thaci-serbia-kosovo-balkans-eu-enlargement-alpbach-forum/>. E qasur më 02 shkurt 2019.

Perendimor tha se "Nuk mendojë se ata (Thaçi dhe Vucic) janë të brengosur me implikimet e mëdha politike. (...) "Mendoj se ata janë më tepër të prirur për interesa personale, fuqi dhe mbijetesë politike".² Ide e pastër gjeopolitike. Akademikë dhe udhëheqës paralajmëruar një precedent të mundshëm të rishkrimit të kufijëve shtetërorë në vija etnike, veçanërisht theksuan shembullin e Bosnjës dhe Herzegovinës, por gjithashtu përmendën edhe shembuj të tjerë të diversitetit etnik në Maqedoni dhe Mal të Zi. Ka shqetësime se "bisedimet mes Serbisë dhe Kosovës nuk do të zgjidhin problemet ekzistuese, por do të krijojnë probleme të reja, nese vazhdojnë në drjetimin e tanishëm",³ theksoi Këshilli Evropian për Marrëdhëniet e Huaja.

Qeveria e Shteteve të Bashkuara, një vend aleat i madh i Kosovës, pohoi se nuk do të refuzojë marrëveshjen, në qoftëse është e kënaqshme dhe pajtohen të dy palët. "Pozicioni i politikës amerikane është se nëse dy palët pajtohen dhe arrijnë të bëjnë marrëveshje, duke mos përjashtuar rishikimet territoriale, nuk na takon neve ta kundërshtojmë"⁴, deklaroi Këshilltari i Sigurimit Kombëtar, Xhon Bolton. Marrëdhëniet diplomatike mes SHBA-ve dhe Kosovës janë mjaft të mira, SHBA-të kanë qenë shumë përkrahës në procesin e shtet-formimit të Kosovës dhe njohjes së gjerë nga komuniteti ndërkombëtarë. Lidhur me marrëveshjen apo rezultatin final të bisedimeve për normalizim, ata janë të gatshëm të pranojnë çdo marrëveshje që është "gjithëpërfshirëse dhe e qëndrueshme, dhe ka përkraje të gjerë publike në të dy shtetet"⁵. Nga rradhët e Brukselit, të dy, Frederika Mogerini dhe Johanes Han, kanë shfaqur përkrahjen e tyre të vazhdueshme për vazhdimin e bisedimeve bilaterale, si dhe kanë pohuar se drejtimi i ndjekur nuk do të destabilizonte rajonin. Megjithatë, duke luajtur me kartën diplomatike për të mos i demoralizuar përpjekjet e tyre konstruktive, që të vazhdojnë përpara në këtë përpjekje për arritjen e paqes, Mogerini deklaroi se BE-ja do të njihte çdo marrëveshje të arritur mes dy palëve, po qe se është "në pajtim me normat ndërkombëtare dhe ato të BE-së"⁶. Ky qëndrim ishte mjaft kontravers dhe shumë më fleksibil se qëndrimet e anëtarëve kyq të shteteve anëtare të BE-së. Shembull tipik është ai i Gjermanisë. Gjermania ishte vendi më i zëshëm nga shtetet anëtare të BE-së në kundërshtimin e kësaj ideje, në krye me kancelaren Angela Merkel e cila ka pohuar se "Integriteti territorial i vendeve të Ballkanit Perëndimor është i vendosur dhe i pakthyeshëm. Kjo duhet përsëritur e përsëritur ngase vazhdimisht ka tentativa për të hapur diskutime mbi kufijtë dhe kjo nuk duhet të ndodh"⁷. Për më tepër, ministri i Jashtëm gjerman, Heiko Mas përsëriti se "nuk besojmë se bisedimet për shkëmbim terrioresh do të mund të jenë produktive. Ne besojmë se kjo do të hapte shumë plagë të vjetra tek qytetarët. Për këtë arsye ne jemi shumë skeptikë për atë"⁸ Gjithashtu, politikanët Britanik theksuan se "normalizimi i marrëdhënieve mes Serbisë dhe Kosovës është qenësor për sigurinë, stabilitetin dhe prosperitetin e dy shteteve si dhe mbarë rajonit." (...) Kjo duhet të jetë në bazë të

² Euronews, "Shpjegimi i ndryshimeve të mundshme kufitare Serbi-Kosovë: Çfarë është në rrezik? ", 27 gusht 2018, <https://www.euronews.com/2018/08/27/serbia-kosovo-possible-border-changes-explained-what-s-at-stake->. E qasur më 2 Shkurt 2019.

³ Këshilli Evropian për Marrëdhënie me Jashtë, " Çmimi i normalizimit: Serbia, Kosova dhe një marrëveshje e rrezikshme kufitare ", 13 nëntor 2018, https://www.ecfr.eu/article/commentary_the_price_of_normalisation_serbia_kosovo_and_a_risky_border_deal. E qasur më 2 Shkurt 2019.

⁴ Politico, 'SHBA e hapur për ndryshimet e kufirit të Kosovës, thotë këshilltari i Trump', 2 gusht 2018, <https://www.politico.eu/article/kosovo-border-changes-us-opinion-donald-trump-john-bolton/>. E qasur më 2 Shkurt 2019.

⁵ Këshilli Evropian i Marrëdhënieve me Jashtë, " Çmimi i normalizimit: Serbia, Kosova dhe një marrëveshje e rrezikshme kufitare ", 13 nëntor 2018.

⁶ Politico, " Mogherini mbron bisedimet mbi ndryshimet kufitare të Kosovës ", 31 gusht 2018, <https://www.politico.eu/article/federica-mogherini-kosovo-serbia-defends-border-change-talks/>. E qasur më 2 Shkurt 2019.

⁷ Politico, " Angela Merkel: Nuk ka ndryshime në kufirin ballkanik ", 13 gusht 2018, <https://www.politico.eu/article/angela-merkel-no-balkan-border-changes-kosovo-serbia-vucic-thaci/>. E qasur më 7 mars 2019.

⁸ Politico, " Evropa lufton me dhimbje koke të re të Ballkanit ", 31 gusht 2018, <https://www.politico.eu/article/europe-struggles-with-new-balkan-headache-borders-change/>. E qasur më 2 Shkurt 2019

njohjes së kufijëve të shteteve të pavarura përbrenda kufijëve të tyre aktual".⁹ Mundësia e përshkallëzimit të mosmarrëveshjeve në vendet e tjera të rajonit është arsyeja pse shumë liderë po e konsiderojnë këtë ide të dy presidentëve si të njëanëshme, të rrezikshme dhe me pasoja ndërkombëtare.

Përveq kontestimit të kësaj ideja nga BE-ja, kjo ide ka trazuar edhe politikën e brendshme të Kosovës. Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj ka kundërshtuar haptazi idenë e shkëmbimit të territoreve, me ç'rast deklaroi se me hapjen e temës së kufijëve të vjetër, rihapet tema e kaluar e "luftës"¹⁰ në gadishullin Ballkanik. Për më tepër, në Prishtinë u organizuan protesta massive kundër marrëveshjes për shkëmbimin e mundshëm të territoreve, gjë që mund të nxisë destabilizimin e mëtejshëm të rajonit¹¹.

Vendosja e taksës ndaj Serbisë

Pikërisht, gjatë përpjekjeve për të ndaluar bisedimet lidhur me idenë kontraverse, u shfaq një temë tjetër e nxehtë. Kësaj rradhe, një temë që nuk i përkiste natyrës gjeo-politike, por asaj tregtare.

Që nga shpallja e Pavarësisë në vitin 2008, shtetësia e së cilës nuk ka arritur të njihet mjaftueshë, Republika e Kosovës është përballur me sfida të mëdha në procesin e integritetit në institucionet ndërkombëtare. Përpjekja e saj e fundit, në nëntor të vitit 2018, për antarësim në Interpol dështoi, Kosova nuk arriti të marrë shumicën e dy të tretave të votave të nevojshme, kryesisht si pasojë e lobimit të fortë të Serbisë dhe Rusisë kundër saj¹². Për të futur edhe më tepër inat, ministri i brendshëm i Serbisë, Nebojsa Stefanoviq, në sallën e Asamblesë së Përgjithme, ku u mbajt votimi, ngriti një parullë të shkruar në serbisht "Fitore"¹³. Por reagimi i qeverisë së Kosovës ishte i shpejtë me rritjen e taksës për importet serbe nga 10% në 100%, si kundërpërgjigje e "kampanjës së fuqishme kundër Kosovës, në rafshin ndërkombëtar"¹⁴. Duke mos patur asgjë për të humbur, pas dështimit për anëtarësim në Interpol, qytetarët e Kosovës e përkrahën fuqishëm vendosjen e taksës.

Natyrisht, kundërpërgjigjet e tilla nuk sjellin efekte pozitive në procesin e normalizimit të marrëdhënieve. Ishte i shpejtë reagimi i Federica Mogherinit, ku i kërkoi qeverisë së Kosovës anulimin e vendimit mbi taksën – ngase sipas saj "është shkelje e pastër e Marrëveshjes Evropiane për Tregti të lirë (CEFTA-s), dhe e Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asocim mes Bashkimit Evropian dhe Kosovës."¹⁵ Gjithashtu në Janar të 2019-tës, Bashkimi Evropian përsëriti kërkesën për heqjen e taksës¹⁶, e cila poashtu u ripërsërit në fillim të marsit 2019, nga kryetari i Komitetit

⁹ Poashtu

¹⁰ Poashtu

¹¹ Radio Evropa e Lirë, " Mijëra protestojnë në Kosovë mbi mundësinë e shkëmbimit të territoreve me Serbinë ", 29 shtator 2018, <https://www.rferl.org/a/protest-in-kosovo-over-possible-land-swap-with-serbia/29516478.html>. E qasur më 8 mars 2019.

¹² Euronews, " Kosovës i mohohet hyrja në Interpol ", 20 nëntor 2018, <https://www.euronews.com/2018/11/20/kosovo-denied-entry-to-interpol>. E qasur më 3 shkurt 2019.

¹³ Poashtu.

¹⁴ BBC News, 'Kosova godet Serbinë me 100% taksë përkundër pritjeve për Interpol', 21 nëntor 2018, <https://www.bbc.com/news/world-europe-46287975>. E qasur më 3 shkurt 2019.

¹⁵ Veprim i jashtëm i Bashkimit Evropian, " Deklaratë e Federica Mogherini mbi vendimin e Qeverisë së Kosovës për taksën mbi mallrat nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina ", 21 nëntor 2018, https://eeas.europa.eu/headquarters/headquarters-homepage/54242/deklarata-federica-mogherini-kosova-qeveria-vendim-tatimi-mallra-serbia-dhe-bosnia-and_en. E qasur më 3 shkurt 2019.

¹⁶ Evropa në zhvillim, " BE përsërit thirrjen që Kosova të heqë tarifat tregtare ndaj Serbisë ", 28 janar 2019, <https://emerging-europe.com/news/eu-reiterates-call-for-kosovo-to-remove-serb-tarifats-e-tregtis/>. E qasur më 3 shkurt 2019.

të Parlamentit Evropian për Çështje të Jashtme, David Macallister¹⁷. Megjithatë, duhet pranuar se sikur që vendosja e taksës bie ndesh me Dialogun, kampanjat e vazhdueshme të sukseshme lobuese të Serbisë poashtu nuk i përkasin frymës pajtuese. Madje lidhur me këtë çështje nuk është parë që qeverisë së Serbisë i është bërë presion i ngajshëm sikurse Kosovës nga zyrtarët e BE-së lidhur me këto kampanja diplomatike kundër Kosovës.

Një hap i tillë i Kosovës, i paprecedent thelloi edhe më tepër ngërçin, duke ndërruar status qou-n e bisedimeve mes dy qeverive. Nuk qe menduar asnjëherë, se të dy vendet do të këmbngulnin deri në këtë masë. Kosova përkundër kundërshtimit të BE-së këmbngulë se do ta mbajë taksës deri atëherë kur bisedimet me Serbinë të bazohen në "kushte reciproke të njohjes"¹⁸, ndërsa Serbia insiston për të mosvazhduar bisedimet deri sa të hiqet taksa¹⁹. Këto veprime u dënuan nga komuniteti ndërkombëtar për shkak se dëmtuan edhe ato pak gjasa për bisedime konstruktive. Përpos BE-së, edhe Shtetet e Bashkuara kanë ndikim të madh dhe pushtet mbi Kosovën. Presidenti Trump, luti të dy qeveritë, përmes një komenti në një postim të presidentit Thaçi në rrjete sociale, që të bashkëpunojnë në vend se të nxisin një luftë tregtare, ngase "dështimi për të përfitur nga kjo mundësi unike do të ishte një kthim tragjik"²⁰. Në koment po ashtu thuhet se "Shtetet e Bashkuara kanë kontribuar shumë në suksesin e Kosovës si një vend i pavarur dhe sovran", por se "mbështetja e Kosovës nuk është e pakushtëzuar"²¹. Disa muaj më vonë, në janar të 2019-tës, Ambasada e Amerikës në Kosovë u deklarua: "ne paralajmërojmë se Kosova apo çdo shtet tjetër mik i Shteteve të Bashkuara që ndërmerr hapa, të cilët janë në kundërshtim me interesat strategjike tona, nuk do të kalojë pa patur pasoja në marrëdhëniet tona bilaterale"²². Kështu, presioni ndërkombëtarë u rrit përmes përsëritjes se Dialogu nuk duhet dëmtuar, por duhet të përdoret dhe të inkurajohet në mënyrë dobiprurëse – thënë kështu, akterët ndërkombëtar kanë filluar të presin rezultate konkrete në dialog dhe ndërpreje të ngërçeve të shkaktuara nga armiqësia politike.

Në aspektin e brendshëm politik, taksa 100% paraqet një lëvizje e cila po ndan qeverinë kosovare në ata që e përkrahin dhe nuk duan ta tërheqin derisa Serbia ta pranojë Kosovën si shtet të pavarur, dhe në ata që duan t'a suspendojnë për shkak të kërkesës së BE-së dhe SHBA-ve²³. Këta të fundit, duan që taksa të hiqet për hir të asaj që të ruajnë bashkëpunimin e mirëfilltë të Kosovës me SHBA-të. Poashtu, taksa ka rritur tensionet mes koalicioneve partiake, për shkak të frikës nga thirrjet aktuale për zgjidhjeve të parakohshme.

¹⁷ Shërbimi Evropian i Veprimit të Jashtëm, " Vërejtjet nga Kryetari i Komitetit të Punëve të Jashtme të PE, Z. David McAllister ", 4 mars 2019, https://eeas.europa.eu/delegations/iran/59007/remarks-chair-ep-foreign-affairs-komitet-mr-david-mcallister_en. E qasur më 7 mars 2019.

¹⁸ Balkan Insight, " Kosova vendos kushte për të hequr tarifatat për importet serbe ", 29 janar 2019, <http://www.balkaninsight.com/en/article/kosovo-uses-tariffs-as-bait-for-a-final-agreement-with-serbia-01-29-2019>. E qasur më 3 shkurt 2019.

¹⁹ Euronews, " Serbia do të rifillojë bisedimet me Kosovën vetëm pasi të heqë tarifatat, tregon Vuçiq Trump ", 31 Janar 2019, <https://www.euronews.com/2019/01/31/serbia-to-resume-kosovo-talks-only-after-it-scraps-tariffs-vucic-tells-trump>. E qasur më 4 Shkurt 2019.

²⁰ VOA News, " Trump kërkon që Kosova të arrijë 'marrëveshjen historike' me Serbinë ", 18 dhjetor 2018, <https://www.voanews.com/a/trump-urges-kosovo-to-reach-historic-deal-with-serbia/4706336.html>. E qasur më 3 shkurt 2019.

²¹ Ballkani Perëndimor Evropian, " Departamenti i Shtetit i SHBA i kërkon Kosovës të revokojë tarifatat, thotë se mbështetja nuk është e pakushtëzuar ", 15 janar 2019, <https://europeanwesternbalkans.com/2019/01/15/us-state-department-urges-kosovo-revoke-tariffs-says-support-not-unconditional/>. E qasur më 3 shkurt 2019.

²² Reuters, " U.S. i kërkon Kosovës të heqë tarifatat tregtare kundër Serbisë, Bosnjës ", 25 janar 2019, <https://uk.reuters.com/article/uk-kosovo-usa/us-urges-kosovo-to-lift-trade-tariffs-against-serbia-bosnia-idUKKCN1PJ1XR>. E qasur më 4 Shkurt 2019.

²³ Balkan Insight, " Taksat e importit mund të përmbysin qeverinë e Kosovës, Kryetari paralajmëron ", 3 janar 2019, <http://www.balkaninsight.com/en/article/kosovo-controversial-tax-to-serbia-opens-snap-elections-debate-01-30-2019?fbclid=IwAR2si0biOEdoTVUllZM9P9-NaRvrTXHOHgbeJTjZr6bGOHfJIRUZoukFro>. U arrit 4 Shkurt 2019.

Ngërçi në bisedimet për normalizim të marrëdhënieve me Serbinë po ndjehet sikur në qeverinë e Kosovës, po aq edhe në zyrat qendrore të Brukselit. Vendosja e taksës ka lëkundur aleatët e mëdhënjë botëror lidhur me mbarëvajtjen e Dialogut. Meqenëse, po ta shikojmë realisht, nuk është se vetëm taksa 100% e Kosovës mbi produktet serbe ka dëmtuar Dialogun, ngase Dialogu vetvetiu nuk po tregonte ndonjë progres, si dhe nuk ishte konstruktiv në marrëdhëniet reciproke. Pra, nëse e konsiderojmë taksën, ashtu siç pohon Serbia, si një pengesë në Dialog, atëherë edhe kampanjën diplomatike të vetë Serbisë kundër sovranitetit të Kosovës, duhet ta vlerësojmë si të tillë. Pavarësisht realitetit, në këndvështrimin e BE-së dhe atë ndërkombëtar, taksa krijoi edhe një pengesë tjetër në bisedimet vetëm se të brishta, mes dy shteteve, Kosovës dhe Serbisë.

Kosova miraton formimin e ushtrisë

Ideja kontraverse për shkëmbimin e territoreve dhe taksa e famshme, u pasuan me një tjetër hap të madh, formimi i ushtrisë e që ngjalli mjaft reagime nga ndërkombëtarët. Me 14 dhjetor 2018, Parlamenti i Kosovës votoi pro formimit të ushtrisë së armatosur rëndë, për dallim nga Forca e Sigurisë së Kosovës e cila ishte lehtë e armatosur²⁴. Në kohën kur dialogu po kalonte një periudhë të tensionuar, një veprim i tillë u prit me mirë nga shumë akterë, edhe pse nuk ishte jashtë kornizave ligjore ngase – amandamentet ligjore mbi statusin dhe mandatin e FSK-së parashohin tranzicionin e saj në ushtri, ku parashihej se mund të të zgjasë rreth 7-10 vjet, duhet të bëhet me bashkëpunimin e aleatëve të Kosovës, si SHBA-të. Megjithatë, duke pasur parasysh rrjedhën e brishtë të negociatave dhe marrëdhënie të tensionuara bilaterale, natyrisht një vendim i tillë, nuk pati ndikime pozitive në këtë rrjedhë.

Edhe pse një vendim sovran i ndërmarrë me pëlqimin e SHBA-ve, si një aleat i saj, dhe nën kornizën ligjore të të drejtave të kufizuara ushtarake, sekretari gjeneral i NATO-s, Xhens Stoltenberg kritikoi këtë akt duke e konsideruar si “të marrë në kohë të papërshtatshme dhe në kundërshtim me këshillat e shumë anëtarëve të NATO-s, e që poashtu mund të ketë pasoja negative në rrugën e Kosovës për antarësim Euro-Atlantik.”²⁵ – një pozicion i tillë pritej nga NATO, duke pasur parasysh se disa anëtare të NATO-s nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Kreu i Operacioneve Paqeruajtëse nga zyrat Qendrore të Kombeve të Bashkura, gjatë raportimit të tij në Këshillin e Sigurimit tha se marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë janë përkeqësuar dhe u kërkoi të dy palëve që të krijojnë kushtet për vazhdimin e Dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja²⁶. Pra, akterët ndërkombëtarë e konsideruan këtë vendim si pengesë në mirëmbajtjen e marrëdhënieve të mirëfillta fqinjësore. Por, kryeministri, Haradinaj rikujtoi se “thëniet se Kosova do të përdorë ushtrinë e saj kundër serbëve të Kosovës dhe fqinjëve janë të paqena. Por përkundrazi ushtria e Kosovës është një forcë ushtarake, moderne, multietnike që është krijuar së bashku me NATO-n dhe KFOR-in, përkatësisht ushtarët dhe oficerët e tyre në vendin tonë”²⁷.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë përkrahur më së shumti amandamentin për statusin dhe mandatin e Ushtrisë. Ambasada Amerikane në Kosovë u deklarua se “është e përkushtuar të bashkëveprojë me Ushtrinë e Kosovës për të promovuar zhvillimin profesional dhe

²⁴ New York Times, " Parlamenti i Kosovës voton për të krijuar një ushtri, duke sfiduar Serbinë dhe NATO-n ", 14 dhjetor 2018, <https://www.nytimes.com/2018/12/14/world/europe/kosovo-army-serbia-nato.html>. E qasur më 4 shkurt 2019.

²⁵ NATO, " Deklarata e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s Jens Stoltenberg pas bisedave me Presidentin e Serbisë Aleksandar Vuçiç dhe z. Ramush Haradinaj Kryeministrit të Kosovës, 6 dhjetor 2018, https://www.nato.int/cps/en/natohq/lajme_161447.htm. E qasur më 5 shkurt 2019.

²⁶ Lajmet e OKB-së, " Lëvizjet për krijimin e një ushtrie të Kosovës kanë përkeqësuar marrëdhëniet' me Serbinë: shefi i paqeruajtjes së OKB-së, 17 dhjetor 2018, <https://news.un.org/en/story/2018/12/1028811>. E qasur më 5 shkurt 2019.

²⁷ Poashtu

organizativ të saj”.²⁸ Qëllimi dhe shpresa e fundit e komunitetit ndërkombëtar dhe gjithë parterëve global mbetet arritja e një marrëveshje me njohje reciproke, e cila do të evitonte çdo konflikt të mundshëm mes dy fqinjëve. Por, problemi është se askush nuk po gjen një rrugë të shpejtë për të tejkaluar me sukses ngërçin e krijuar aktual.

Rrugëtimi i paparashikuar i Dialogut

Për zbutjen e tenisoneve u bënë thirrje nga gjitha anët, si nga NATO, shefat e Kombeve të Bashkuara dhe ata të BE-së. Nevoja për një dialog gjithëpërfshirës dhe transparent është më madhe se kurrë. Një tjetër institucion i BE-së, që ka mbështetur dialogun përveç Komisionit është Këshilli i BE-së. Për shembull, Austria, përkatësisht presidenca e kaluar, ka përkrahur idenë kontraverse për shkëmbim territore, përkundër kundërshtimit të madh të shumë shteteve anëtare të BE-së, e veçanërisht Gjermanisë, siç e përmendëm më lartë. Por, qëllimi i tyre është që të arrihet paqja e qëndrueshme mes dy vendeve, e në qoftëse është e nevojshme edhe përmes korrigjimit të kufijëve²⁹. Gjithashtu Mbretëria e Bashkuar një tjetër vend kyq, në mbledhjen e Këshillit të Sigurimit të OKB-së për normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, u deklarua se “ Mbretëria e Bashkuar vazhdon të kërkojë nga Kosova që të jetë më e përgjegjshme, të veprojë në mënyrë transparente dhe në konsultim me anëtarët e NATO-s, si dhe të vazhdojë bashkëpunimet ekzistuese me KFOR-in”³⁰. Momentalisht, që nga janari I vitit 2019, Rumania mban presidencën, e ajo është një nga pesë shtetet që nuk e ka njohur Kosovën. Bukureshti e bëri të qartë faktin, në mbledhjen e Këshillit të BE-së me rastin e marrjes së presidencës se edhe pse nuk e njeh shtetësinë e Kosovës, e përkrah dialogun, përkatësisht në atë mbledhje u tha – “Do të doja ta përmendi se ne do të veprojmë si palë ndërmjetësuese, përkundër faktit se nuk e njohim shtetësinë e Kosovës. Rumania e përkrah Dialogun dhe nevojën për të arritur një marrëveshje në pajtim me vlerat themelore të BE-së. Bashkëjetesa dhe respektimi i minoriteteve janë pjesë të këtyre vlerave. Ne besojmë se është më rëndësi për vetë palët bashkëbiseduese dhe gjithë akterët e tjerë të evitojnë çdo gjë që pamundëson arritjen e marrëveshjes.”³¹

Në fakt, Ministri i jashtëm rumun Teodor Melescanuaj kujtoi se Dialogu madje mund të inkurajohet edhe më tepër nga shtetet që kërkojnë të zgjidhin këtë çështje politike të vazhdueshme të mosnjohjes. Ai tha gjatë takimit jozyrtar të ministrave të punëve të jashtme të BE-së që u mbajt në Vjenë në gusht 2018, se "zgjidhja më e mirë është të kemi një mirëkuptim dypalësh midis Serbisë dhe Kosovës, por na duhet edhe ndihma e vendeve të tjera që nuk e kanë njohur Kosovën për të arritur një vendim përfundimtar në lidhje me këtë çështje".³²

Kosova duke u munduar që të përcjellë një mesazh bashkëpunimi, pavarësisht tensioneve brenda partive dhe çarjeve midis kolaicioneve, kohët e fundit mblodhi një ekip të ri negociues për

²⁸ Ballkani Perëndimor Evropian, " Reagimet e NATO-s dhe SHBA ndaj miratimit të ligjeve në lidhje me Forcat e Armatosura të Kosovës ", 14 dhjetor 2018, <https://europeanwesternbalkans.com/2018/12/14/nato-usa-reactions-adoption-laws-concerning-kosovo-armed-forces/> E qasur më 5 shkurt 2019.

²⁹ Observer i BE, " Austria: BE do të mbështesë shkëmbimin e territorit Kosovë-Serbi ", 7 nëntor 2018, <https://euobserver.com/tickers/143313>. E qasur më 5 shkurt 2019.

³⁰ Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, " Normalizimi i qëndrueshëm përmes dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë - fjalim ", 17 dhjetor 2018, <https://www.gov.uk/government/speeches/sustainable-normalisation-through-dialogue-between-kosovo-and-serbia>. E qasur më 8 mars 2019.

³¹ Agjencia e Pavarur e Lajmeve Ballkanike, 'Opinion / Prioritetet e presidencës rumune të BE dhe qasja e saj ndaj mosmarrëveshjeve Kosovë-Serbi', 23 janar 2019, <https://balkan.eu.com/opinion/priorities-of-the-romanian-presidency-e-eu-dhe-qasja-e-saj-drejt-kosoves-serbia-kontestet/>. E qasur më 5 shkurt 2019.

³² Komisioni Europian, " Arritja dhe pragu nga (në anglisht) nga Teodor MELESCANU, Ministri i Punëve të Jashtme të Rumanisë ", 31 gusht 2018, <https://ec.europa.eu/avservices/video/player.cfm?ref=I159826>. E qasur më 6 shkurt 2019.

të shkuar në Bruksel për të diskutuar me homologët serbë dhe Federica Mogherinin³³ rreth disa temave si; çështja e personave të zhdukur dhe dëmshpërblimet e luftës.

Megjithatë, kjo iniciativë u dëmtua nga një hendek gjinor ngase ekipi i zgjedhur prej nëntë anëtarësh për bisedimet për paqe, përbëhej vetëm nga meshkujt³⁴, ndërsa përfshirja dhe përfaqësimi i grave në proceset paqësore është qenësore për ndërtimin e stabilitetit të qëndrueshëm. Formimi i delegacionit shtetëror të lartpërmendur për të shërbyer si ekip negociues në Bruksel u përball me trazira politike të brendshme në mungesë të konsensusit politik, domethënë nga dy partitë më të mëdha të opozitës, LDK dhe Vetëvendosje, të cilat "bojkotuan seancën e dhjetorit dhe refuzuan ftesat për të qenë pjesë e ekipi negociator"³⁵. Në fakt, tema kryesore përçarëse mbetet pjesëmarrja e Presidenti Thaçi në Dialog. Sidomos, në një kohë kur vetë Thaçi ka hapur temën për shkëmbimet e mundshme të territoreve. Shumica e figurave politike në Kosovë kanë shprehur mospëlqimin e tyre për rolin e tij, duke përsëritur nevojën që çështja për procesesin e negociimit të rikthehet në Kuvendin e Kosovës.

Ndërsa zhvillimet e brendshme në Kosovë janë bërë tituj anë e mbanë, trazirat e brendshme në Serbi kanë qenë gjithashtu në qendër të vëmendjes. Që nga dhjetori 2018 dhe tani në muajin e tyre të tretë, në shumë qytete të mëdha serbe janë organizuar protesta masive kundër asaj që po konsiderohet një sundim jodemokratik i Presidentit Aleksandar Vuçiç³⁶. Në protestat masive kanë marrë pjesë qytetarë nga të gjithë spektri politik, të cilët kanë bërë thirrje për dorëheqjen e tij, e që në media po quhen si "1 në 5 milionë protesta", duke aluduar në deklaratën e Vuçiçit se ai nuk do t'i pranojë kritikën edhe nëse pesë milionë njerëz do të kundërshtonin qeverisjen e tij³⁷. Qytetarët po kërkojnë shumë ndryshime dhe një ndryshim të regjimit më autokratik që Vuçiç dhe Partia Progresive në pushtet (SNS) kanë sjellë³⁸. Klima e tensionuar politike në Serbi bëri që protestuesit të hyjnë me forcë në ndërtesën e televizionit publi duke shprehur drejtpërdrejt nevojën e madhe që ka vendi për shprehjen e lirë të medias, të cilët u ndaluan më pas nga policët³⁹. SNS kohët e fundit ka parashtruar idenë e mbajtjes së zgjedhjeve të parakohshme në një përpjekje për të qetësuar demonstratat anti-qeveritare, por një vendim zyrtar apo një mesazh i qartë nga Presidenti ende nuk është ndërmarrë⁴⁰. Në dritën e trazirave të brendshme dhe situatës serioze politike, organizata e mirënjohur vëzhguese Freedom House kohët e fundit ndryshoi rezultatin e lirisë totale në Serbi nga "e Lirë" në "Pjesërisht të Lirë".⁴¹ Përkeqësimi i rezultateve shpjegohet nga organizata si shkak i parregullsive zgjedhore, parregullsive ligjore dhe fushatave përulëse ndaj gazetarëve të pavarur si dhe akumulimit de facto të kompetencave jashtëkushtetuese të Presidentit Aleksandër Vuçiç⁴². Presioni i rritur po afekton stabilitetin socio-politik të Serbisë. Protestat masive në Serbi tashmë u ndalën në mes të

³³ Poashtu.

³⁴ Prishtina Insight, "Ekipi negociator i Kosovës kryeson Brukselin", 8 janar 2019, <https://prishtinainsight.com/kosovo-negotiation-team-heads-to-brussels/>. E qasur më 8 mars 2019.

³⁵ Prishtina Insight, "Ekipi negociator i Kosovës kryeson Brukselin", 8 janar 2019, <https://prishtinainsight.com/kosovo-negotiation-team-heads-to-brussels/>. E qasur më 8 mars 2019.

³⁶ Balkan Insight, "Dhjetëra mijëra bashkohen me marsin e fundit të protestave të Serbisë", 2 shkurt 2019, <http://www.balkaninsight.com/en/article/tens-of-thousands-in-a-new-serbian-anti-govt-march-02-01-2019?fbclid=IwAR32DvG3Im5Tf3GfihnojPunRv-D8RoDHsL4LxXbAiYTx5JSD-FJ1v2xGuU> E qasur më 5 shkurt 2019.

³⁷ Euronews, "Partia qeverisëse serbe dëshiron zgjedhje të parakohshme pas muajsh protesta anti-qeveritare", 26 mars 2019, <https://www.euronews.com/2019/03/26/serbian-ruling-party-wants-early-elections-after-months-of-anti-government-protests>. E qasur më 26 mars 2019.

³⁸ Poashtu.

³⁹ Balkan Insight, "Protestuesit serbë stuhi në ndërtesën e transmetuesit kombëtar", 17 mars 2019, <https://balkaninsight.com/2019/03/16/serbian-protesters-storm-national-broadcaster-building/>. E qasur më 26 mars 2019.

⁴⁰ Euronews, "Partia qeverisëse serbe kërkon zgjedhje të parakohshme pas muajsh protesta anti-qeveritare", 26 mars 2019.

⁴¹ Freedom House, "Serbia", <https://freedomhouse.org/report/freedom-world/2019/serbia>. E qasur më 26 mars 2019.

⁴² Poashtu

janarit, kur presidenti rus Putin vizitoi vendin aleat⁴³. Duke u munduar të shfaqë forcën e tij, Putin akuzoi NATO-n për destabilizimin e rajonit me perspektivat e anëtarësimit, për t'ua përkujtuar fuqive perëndimore se Rusia ende ka dorë në lojën e Ballkanit. Ekspertët pohojnë se "Perëndimi dëshiron t'i sjellë të gjitha vendet në rajonin e Ballkanit nën ombrellën euroatlantike dhe veçanërisht në atë të NATO-s, dhe deri më tani duket se po fitojnë kundër Rusisë betejën për ndikim në rajon"⁴⁴, me pranimin e Malit të Zi në vitin 2017, si dhe për Maqedoninë e Veriut pritet në vitin 2020. Vizita e Presidentit Putin në Beograd gjithashtu lë të kuptohet se mosmarrëveshja për njohjen dhe integrimin e Kosovës, e aq më pak normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë fqinje, nuk do të jetë i lehtë. Tashmë i vetëdijshëm për peshën e politikës së pushtetit, në fjalimin e tij të fundit në Bashkimin Evropian si President i Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker kujtoi se "Ne duhet të arrijmë një unitet kur bëhet fjalë për Ballkanin Perëndimor - njëherë e përgjithmonë. Nëse nuk e arrijmë atëherë fqinjësia jonë do të pëcaktohet nga të tjerët"⁴⁵. Gjendja e brendshme mund të mos jetë ideale si në Kosovë ashtu edhe në Serbi, megjithatë presioni që të tregojnë gatishmëri për të arritur një marrëveshje përfundimtare po rritet për të dyja palët. Kjo është e vërtetë veçanërisht nën hijen e përparimit diplomatik në kohët e fundit, në Gadishullin Ballkanik: Maqedonia dhe Greqia më në fund e kanë ratifikuar marrëveshjen përfundimtare, duke i dhënë kështu fund mosmarrëveshjes 27 vjeçare për emrin, gjë që kishte bllokuar pranimin e Maqedonisë në NATO apo BE. Si rezultat, aleatët e NATO-s tashmë nënshkruan protokollin⁴⁶ e pranimin të Republikës së Maqedonisë Veriore dhe, po ashtu, rruga tashmë është gjithashtu e hapur për hapjen e bisedimeve të pranimin midis BE dhe Maqedonisë.

Pavarësisht nga historia e suksesit të Ballkanit që ishte Marrëveshja e Prespës, mosmarrëveshja Maqedoni-Greqi ishte e një natyre shumë më të lehtë se sa Dialogu mbi normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, që përfshin tensionet e sovranitetit të kontestuar dhe njohjen e pabarabartë ndërkombëtare. Për dallim nga vendet e tjera Ballkanike, protokollet për antarësim për Kosovën duken si një mundësi e largët. Parakushti i përbashkët i njohjes reciproke ishte i qartë, megjithatë është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se qasja që BE-së ndaj qështjes së Kosovës nuk ishte. Edhe pse shumë fonde të BE-së dhe përpjekje politike orinetohen drejt Kosovës - të cila ndikojnë në zhvillimin e shtetit në përputhje me ligjet e BE-së, - BE-së ende i mungon një agjendë konkrete për mënyrën se si do të vazhdojë rrugën e integritit Kosova. Përveç kësaj, fakti që dy aktorët e vetëm shtetërorë të përfshirë në Dialog nuk janë të sinkronizuar, madje as nuk po marrin pjesë në bisedimet bilaterale, ia vështirësojnë shumë BE-së formimin e një uniteti për hapat vijues të Kosovës. Në të vërtetë, Dialogu ka arritur në një ngërç. Për më tepër, një ngërç i till po ngjante që disa muaj, madje edhe vite, me bisedime kot - siç edhe u përmend në seksionet e mëparshme, ngjarje që BE dhe SHBA i kritikuan, hapa konkrete kur ishte e nevojshme nuk ndërmorrën, por vetëm vështronin gjerësa përshkallëzoheshin.

Nën hijen e ngjarjeve të fundit, palët dialoguese këmbëngulin se status quo-ja për normalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë duhet të rishqyrtohet. Thënë kështu, roli i BE dhe bashkësia ndërkombëtare në tërësi, duhet të ndryshojë Për shembull, BE-ja duhet të vendosë nëse do të jetë ndërmjetësuesi kryesor në Dialog, ose do të bëjë hapin për negociata paralele midis dy aktorëve shtetërorë që të jenë frytëdhënëse. Në fund të ditës, BE-ja nuk ka asnjë

⁴³ EXIT, " Putin viziton Serbinë, çfarë mund të nënkuptojë për Kosovën ", 17 janar 2019, <https://exit.al/en/2019/01/17/putin-visits-serbia-what-it-might-mean-for-kosovoe/>. E qasur më 2 Shkurt 2019.

⁴⁴ Ekathimerini, " Pas marrëveshjes së emrit, vëmendja do të zhvendoset në Kosovë ", 25 janar 2019, <http://www.ekathimerini.com/236958/opinion/ekathimerini/comment/after-name-deal-attention--will-shift-in-kosovo/>. U arrit 6 Shkurt 2019.

⁴⁵ Komisioni Evropian, " Gjendja e Bashkimit 2018 ", 12 Shtator 2018, https://ec.europa.eu/commission/priorities/state-union-speeches/state-union-2018_en. U arrit 2 Shkurt 2019.

⁴⁶ NATO, aleatët e NATO-s nënshkruajnë protokollin e pranimin për Republikën e Maqedonisë Veriore, 6 shkurt 2019, https://www.nato.int/cps/en/natohq/news_163078.htm. E qasur më 8 mars 2019.

të drejtë ligjore të ndërhyjnë në vendimet sovrane të shteteve (si anti-lobimi, tarifet, shkëmbimi i territorit, krijimi i ushtrisë), nëse ata vetëm se vendosin të shpërfillin paralajmërimet ndërkombëtare. Megjithatë, BE-ja nuk duhet t'i trajtojë këto vendime të rëndësisë së vogël, sepse ato mund të kenë pasoja serioze gjeopolitike për të dyja vendet, si dhe gjithë Ballkanin, kështu që vetë BE-ja, duhet të hedh poshtë propozime të tilla si lëvizja e kufirit. Një tjetër mundësi për të penguar bllokimin e vazhdueshëm është që Shtetet e Bashkuara të përfshihen më tepër në Dialog, duke marrë parasysh natyrën e tij të tanishme të brishtë. Shtetet e Bashkuara kanë mbështetur në mënyrë indirekte idenë e korigjimit të kufijëve dhe kanë dështuar për të dënuar vendosjen e taksës 100% ndaj produkteve serbe, veprime të cilat janë në kundërshtim me interesin strategjik kombëtar amerikan në rajon. Ndërkohë, duke i kërkuar Kosovës dhe Serbisë të kthehen në bisedimet e Dialogut në një frymë më bashkëpunuese, që të arrijnë sa më shpejt një marrëveshje përfundimtare. Përveç kësaj, ky reagim, ndoshta disa reagime si vendimet për vizita shtetërore të zyrtarëve të lartë të DC në rajon, do ta shtyenin qeverinë kosovare që të rifillojë Dialogun dhe të pezullojë taksën. Një problem tjetër është, natyrisht, qeveria serbe, e cila vazhdon të përdorë aleancën e saj ruse për të përkujtuar zyrtarët e BE-së që çështja e Serbisë duhet të kalohet sa më shpejtë.

Mbi të gjitha, Brukseli është i prerë në vendosjen e një parakushti për vazhdimin e Dialogut: të dy palët të negociojnë në mënyrë konstruktive për të arritur një marrëveshje përfundimtare ligjore të dobishme për të dyja palët. Në praktikë, një bashkëpunim i tillë shpesh ka dështuar, por raund i ri i bisedimeve shpresohet të fillojë së shpejti në kryeqytetin e BE-së – por vetëm për temat e personave të zhdukur dhe dëmshpërblimet e luftës, ndërsa jo për temën e njohjes. Gjatë gjashtë muajve të fundit ka pasur shumë zhvillime të rëndësishme dhe një ndryshim të lojës në Dialog, të cilat tërhoqën pas vete paralajmërimet ndërkombëtare, dënime dhe thirrje për bashkëpunim. Në rrafshin ndërkombëtar, situata në të cilën ndodhet Dialogu tani duhet të analizohet më thukët, që të gjindet ndoshta një mënyrë për ndryshimin e strategjisë së ndërmjetësimit.

Përmbledhje

Momentumi në të cilin gjendet Dialogu për normalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë është një reflektim i frustrimeve të qeverive dhe humbja e shpresës nga ana e popullatës. Mungesa e perspektivës reale për të arritur një marrëveshje reciproke të dobishme, e aq më pak antarësimi në BE apo NATO, bëri që Kosova të veprojë në përputhje me realitetin e tyre të pafat duke mos pasur asgjë për të humbur. Të ngujuar në një dialog tashmë të brishtë, ku tensionet e larta muajve të fundit midis Kosovës dhe Serbisë kanë përkeqësuar shanset për arritjen e një marrëveshjeje të suksesshme përfundimtare të njohjes reciproke në të ardhmen e afërt. Në Bruksel, tensionet janë të larta kur diskutohet tema e marrëdhënieve Kosovë-Serbi. Johannes Hahn ka shprehur shqetësimin e tij lidhur me idenë e shkëmbimit të territorit të nisur nga Thaçi, Vuçiç dhe Federica Mogherini. Poashtu ka dënuar fuqishëm taksën 100% mbi mallrat serbe pasi konsideron se është në kundërshtim me natyrën e Dialogut dhe me marrëveshjen e CEFTA-s. Këshilli i BE-së, nga ana e tyre, vazhdimisht ka bërë thirrje që dialogut të vazhdojë drejt një marrëveshjeje për paqe të qëndrueshme, pa marrë parasysh shtetin anëtar që mban presidencën.

Për më tepër, një boshllëk pasigurie komplikon çdo pozicion të unifikuar afatgjatë mbi politikën e jashtme ose angazhimin në vetë Dialogun, me Parlamentin Europian dhe me Komisionin Evropian, përbërjet e të cilave do të ndryshojnë në vitin 2019. Ende ka interes të punohet drejt një procesi përfundimtar, një marrëveshjeje të detyrueshme ligjore që do të zgjidhte të gjitha çështjet e pazgjidhura dhe do të mundësonte paqe të qëndrueshme në rajon, përkundër mungesës së angazhimit të përbashkët dhe trukeve gjeopolitike të ushtruara nga dy akterët e implikuar në Dialog.

Kosova dhe Serbia po distancohen gjithnjë e më shumë nga agjenda evropiane, si rezultat i zhvillimit të tensionuar të Dialogut edhe ashtu të brishtë. Reagimet ndërkombëtare kanë qenë të qarta duke kërkuar bashkëpunim dhe dialog. Për dallim nga fqinjët e saj të cilët po shënojnë përparim në rrugën drejt BE-së dhe NATO-s, Kosova ka ngecur në lojën gjeopolitike të Serbisë dhe, kur përpiqet të përfitoj nga pushteti i saj edhe ashtu i limituar, thjesht e përkeqëson gjendjen, gjerësa thirrjet për parandalim të përshkallëzimit të situatës janë të menjëhershme. Sigurisht, sidomos nën hijen e zhvillimeve të fundit, status quo-ja e Dialogut ka rezultuar e papërshtatshme për të mundësuar bisedime dypalëshe konstruktive ose kompromis të vërtetë. BE duhet të zhvendosë dinamikën e fuqisë ose të rishikojë shanset që ka në dorë, sepse në mënyrë të qartë stimujt nuk po japin rezultatet e pritura për shkak të armiqësisë historike midis të dyja palëve.

Shpresojmë se me kalimin e kohës, një marrëveshje tjetër historike midis fqinjëve të Ballkanit do të mund të festohet.

Analiza e Politikave

Analizat e Politikave janë raporte që diskutojnë politikat publike dhe që synojnë të ndikojnë në vendimmarrje, si në nivelin lokal ashtu edhe në atë qendror të qeverisjes. Qëllimi i Analizës së Politikave është të adresojë një problem të veçantë, më në thellësi, të shqyrtoj argumentet e ndërlidhura me politikën përkatëse, dhe të analizojë zbatimin e saj. Përmes Analizës së Politikave, Grupi për Studime Juridike dhe Politike synon të stimulojë debat më të gjërë dhe gjithëpërfshirës mbi çështjen e dhënë, si dhe të ofroj zgjidhje të informuara dhe rekomandime për ndryshimin e politikave publike relevante, kryesisht drejtuar aktorëve dhe grupeve të interesit.



**GROUP FOR LEGAL
AND POLITICAL
STUDIES**

legalpoliticalstudies.org